

**AKT THEMELIMI
STATUTI I SHOQËRISË**

“BUILDER EAGLE”

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007" Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit", u vendos si më poshtë:

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT DHE EMRI I SHOQËRISË

Sot me datë **08/02/2023** unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin" **BUILDER EAGLE** "sh.p.k (në vijim referuar si "Shoqëria").

Themeluesit e shoqërisë është:

1. **Z.ERIJON ADEMI**, Lindur në Itali me **09.09.1997** ,Shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës identitetit me numër **039085783** dhe me Nr **Personal J70909067C**,

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i Shoqërisë do të përfshijë:

- 1- Trajnimi dhe ofrimi i shërbimit të dhënies borxh të punonjësve të shoqërisë për shoqëri brenda dhe jashtë vendit (Distacco Transnazionale).
- 2- Aktivitete në fushën e ndërtimit , ndërtim objektsh rezidenciale dhe jo rezidenciale, tregtim me shumicë dhe pakicë të lëndëve të ndryshme që shërbejnë në fushën e ndërtimit etj.
- 3- Studimi, projektimi, supervizion i punimeve dhe ndërtimi i objekteve të ndryshme, ushtrim i aktivitetit të studimit, projektimit dhe ndërtimit të të gjitha llojeve.
- 4- Kryerja e çdo lloj aktiviteti të lejueshëm nga ligji për formën juridike të subjektit.

ERIJON ADEMI



NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pa caktuar.

**NENI 4
SELIA**

- (I) Durres Durres DURRES Katund i ri, Erzen, Durres, Nd. 24 H1.1, Nr pasurie 70/41 zk 1595
(II) Adresa e shoqërisë për komunikime elektronike është si vijon: **Erijon.ademi@hotmail.it**

**NENI 5
TË NDRYSHME**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të zmadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

**KREU II
KAPITALI**

**NENI 6
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është **100.000 leke**.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **ERIJON ADEMI** Zoteruesi **1 (një) kuotë** me vlerë të përgjithshme **100.000 lekë** që përben **100 % të kapitalit themeltar** të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta).

**NENI 7
ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontributesi pas kërkesës së Administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

ERIJON ADEMI



**NENI 8
TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i koutës nga çasti i kalimit të koutave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

KREU III

ORGANI VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 9

ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështje të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe heqjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme, përjashtohet rasti kur Administratori është dhe ortak i vetëm.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

ERIJON ADEMI

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME



Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditëve t'udërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 11 KOURUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, përndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:


- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 13 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

ERIJON ADEMI


d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortakët përfaqësohen nga një përfaqësuesi autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakët, të cilin përfaqëson.

NENI 14 ADMINISTRIMI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje nëpërmjet vendimit të asamblese së ortakëve të Shoqërisë.

Në asnjë rast ortakëve nuk ju duhet të justifikojnë apo të provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat shkarkohet Administratori.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1. Administratori i Shoqërisë është **Z.ERIJON ADEMI**, Lindur në Itali me **09.09.1997**, Shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës identitetit me numër **039085783 dhe me Nr Personal J70909067C**, nga data **08.02.2024 deri me date 07.02.2029**, me të drejtë ripërtëritjeje nëpërmjet vendimit të asamblese së ortakëve të Shoqërisë.

NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdeset përmbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatisë dhe nënshkruaj në bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e edukur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përveprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblye të Përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit

ERIJON ADEMI

5



financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 16

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëme shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveçsa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

1. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mos veprimi është kryer në mirëbesim.

2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çd fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitën e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimete mëposhtme:

- a) U kthen ortakëve kontributet;
- b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) U shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuese për të shlyer detyrimet;
- d) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

ERIJON ADEMI



NENI 17

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 18

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 19

EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregëtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzoje në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 20

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 te Nenit 43 te ligjit Nr.9273 date 03.05.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) Me vendim te Gjykatës
- f) Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apodisa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëria në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

ERISON ADEMI



Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 21

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 22

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozita të legjislacionit Shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 23

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I SHOQËRISË

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BUILDER EAGLE" sh.p.k.

Z. ERIJON ADEMI

ERIJON ADEMI

